

RAPORT I PËRKOHSHËM
3-21 Nëntor 2016

25 Nëntor 2016

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Pas dy viteve krizë politike, forcat kryesore politike u dakorduan që të shpërbëjnë parlamentin për here të dytë këtë vit. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan për 11 dhjetor. Më 3 nëntor, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) formoi Misionin Vëzhgues të Zgjedhjeve (MVZ) për të vëzhguar këto zgjedhje.
- Korniza ligjore zgjedhore është reviduar rrënjësisht në vitin 2015. Ndryshimet e mëtejshme në vitin 2016 vendosën mekanizma të përkohshëm për mbikëqyrje politike të procesit zgjedhor duke përfshirë kriterin që qytetarët me të dhëna “të kontestueshme” në listën e votuesve të regjistruar në mënyrë aktive për këto zgjedhje, si dhe formimin e Komisionit të Përkohshëm për mbikëqyrje të mediave.
- Seancat zyrtare të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) deri tani ishin të hapura për vëzhguesit dhe për mediat. Mirëpo, KSHZ-ja po ashtu mblidhej shpeshherë edhe në seanca punuese të mbyllura ku u mbajtën biseda të rëndësishme. Shumica e Komisioneve Komunale Zgjedhor janë funksional dhe përgatitjet janë në rrjedhë e sipër, por disa kanë mungesë të pajisjeve dhe hapësirës së nevojshme. Dispozitat për përfaqësim të barabartë gjinor dhe të grupeve etnike duket se po respektohen në administratën zgjedhore.
- Janë gjithsej 1.784,524 votues paraprakisht të regjistruar për këto zgjedhje. Meqë mosbesimi në saktësinë e listës së votuesve ishte prezent gjatë zgjedhjeve të mëparshme, KSHZ-ja ishte detyruar për t’u shqyrtuar listën. Shqyrtimin e bëri me kryqëzimin e disa bazave të të dhënave si dhe me realizimin e kontrollit në terren. Në bazë të mandatit të saj që del nga amendamenti i ri në Kodin Zgjedhor, KSHZ-ja fshiu 28,341 votues nga lista të cilët nuk ishin reregjistruar. Edhe përkaj disa kritikave për kontrollimet në terren, një numër i bashkëbiseduesve të MVZ të OSBE/ODIHR ishin të mendimit se besueshmëria e publikut në Listën e votuesve është rritur pasi që procesi i shqyrtimit të listës deri tani ka çuar deri në numër të kufizuar të kërkesave për korrigjime.
- KSHZ-ja aprovoi 20,629 aplikime për votim jashtë vendit. Shumë kërkesa ishin të bëra nga një adresë elektronike. Disa parti politike deklaruan për MVZ të OSBE/ODIHR se ato kanë ndihmuar votuesit e tyre gjatë aplikimit.
- KSHZ-ja regjistroi, në mënyrë gjithëpërfshirëse 58 lista të kandidatëve të dorëzuara nga 6 parti politike dhe 5 koalicione. Kërkesa për 40 për qind përfaqësim gjinor në listat është respektuar. Listat e dy garuesve më të mëdhenj përfshijnë edhe përfaqësues të komuniteteve më të vogla etnike, prej të cilëve disa gjenden në pozita me mundësi për të fituar. Disa parti opozitare shprehën qëllimin e tyre për të kërkuar votat nga komuniteti etnik shqiptar.
- Shumica e partive politike filluan me mobilizimin e elektoratit të tyre para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore e cila filloi më 21 nëntor. Atmosfera parazgjedhore në përgjithësi ishte e qetë,

me disa incidente dhune të izoluar të regjistruar. Te MVZ i OSBE/ODIHR u raportua edhe një numër pretendimesh për trysni të ushtruar mbi të punësuarit në administratë për mbështetje të disa partive të caktuara politike.

- Nga mediat publike kërkohet të mbulojnë në mënyrë të drejtë në lajme të garuesve në zgjedhje, të mundësojnë qasje në emetim falas dhe të organizojnë debate. Reforma të konsiderueshme për mediat të parashikuara në marrëveshjen e Përzhdinos mbeten çështje për tu dakorduar. Bashkëbiseduesit e MVZ të OSBE/ODIHR shfaqën shqetësime për vetë-censurimin mjaft të përhapur si rezultat i presioneve politike mbi mediat dhe për rastet e gjuhës nxitëse dhe sulmeve verbale mbi gazetarë. Më 7 nëntor, MVZ e OSBE/ODIHR filloi vëzhgimin kualitativ dhe kuantitativ të mediave.
- Dy organizata të mirënjohura qytetare, MOST dhe CIVIL, do t'i vëzhgojnë zgjedhjet. MOST planifikon të bëjë numërim tabelor paralel të votave.

II. HYRJE

Në bazë të ftesës zyrtare, më 3 nëntor Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut/ (OSBE/ODIHR) filloi Misionin për Vëzhgim të Zgjedhjeve (MVZ) për të vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit¹. MVZ i kryesuar nga Tana de Zulueta përbëhet nga një ekip kryesor prej 14 personave me seli në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë (VAGj) të vendosur në vende të ndryshme të vendit më 9 nëntor. Anëtarët e misionit janë të zgjedhur nga 22 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Nga shtetet pjesëmarrëse u kërkua të dërgojnë 300 vëzhgues afatshkurtër (VASH) për të vëzhguar procedurat në ditën e zgjedhjeve.

III. HISTORIKU DHE KONTEKSTI POLITIK

Pas zgjedhjeve parlamentare të parakohshme në vitin 2014, në parlament u përfaqësuan gjashtë parti politike dhe koalicione. Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) me 61 deputetë dhe Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI) me 19 deputetë e formuan qeverinë. Opozita përfshinte Lidhjen Social-Demokratike të Maqedonisë (LSDM) me 34 deputetë dhe Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH) me 7 deputetë. Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) dhe Opsioni Qytetar për Maqedoninë (GROM) kishin nga një deputet.

Opozita pretendonte se zgjedhjet në vitin 2014 ishin të manipuluar dhe vendosi që përkohësisht të bojkotojë parlamentin. Kriza u thellua në shkurt të vitit 2015 me “skandalin e përgjimeve” kur u publikuan përgjimet inkriminuese në të cilat supozohet se zyrtarë publik dhe qeveritarë janë të përfshirë në korrupsion, manipulim zgjedhor, keqpërdorim të detyrës dhe përgjim të paligjshëm, që çoi në protesta të qëndrueshme dhe të gjëra. Më 2 qershor, si pjesë e Marrëveshjes në Përzhdino, fillimisht zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan për në 24 prill 2016.²

Zgjedhjet pastaj u zhvendosën për në 5 qershor me arsye se kushtet kryesore nuk ishin të plotësuara, siç ishin pastrimi i Listës së votuesve, reformat në media dhe masat mbrojtëse për ndarjen e shtetit nga aktivitetet partiake. Para zgjedhjeve opozita paralajmëroi bojkotimin e tyre dhe prej katër

¹ Shih <http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/279061> për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

² Marrëveshja e Përzhdinos dhe Protokollin nga 15 korriku ishin të firmosur nga katër grupet parlamentare (PDSH, BDI, VMRO-DPMNE dhe LSDM) dhe fton në implementimin e masave për zgjidhjen e krizës politike, duke përfshirë edhe reformat zgjedhore dhe të mediave.

nënshkruesve të marrëveshjes në Përzihino, vetëm VMRO-DPMNE dorëzoi listën e kandidatëve. Më 25 maj, Gjykata Kushtetuese shpalli shpërbërjen e parlamentit si antikushtetues dhe zgjedhjet e 5 qershorit u anuluan.

Më 20 korrik, me ndihmën e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, katër partitë kryesore arritën një marrëveshje të re.³ Në te theksohen dy kushte për mbajtje të zgjedhjeve; përmirësimi i saktësisë së Listës së votuesve dhe përforcimi i kornizës ligjore për mediat. Më 31 gusht, katër partitë deklaruan se kushtet për “zgjedhje të besueshme” janë plotësuar dhe zgjedhjet u caktuan për 11 dhjetor. Më 17 tetor, pas dy viteve krizë politike, parlamenti u shpërbë për here të dytë këtë vit.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE

Prej 120 deri 123 deputetë do të zgjidhen me mandat katërvjeçar përmes sistemit proporcional të përfaqësimit dhe përdorimit të listave të mbyllura. Njëzet deputetë do të zgjidhen nga secila prej gjashtë njësive zgjedhore në vend dhe deri tre deputetë prej një njësie zgjedhore jashtë vendit.⁴ Kodi Zgjedhor lejon devijime deri më 5 për qind nga numri mestar i votuesve të regjistruar për njësitë në vend. Më 25 tetor partia Uniteti sfidoi mbajtjen e zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese pasi njësia numër 6 devijon me 5.65 për qind. Gjykata ende nuk ka vendim për këtë çështje.

Zgjedhjet parlamentare udhëhiqen sipas një sërë dokumentesh të cilët përfshijnë Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Financim të Partive Politike, dispozitat e Kodit Penal, Ligji për Mediat dhe Ligji për Media dhe Shërbime Audio dhe Audiovizuale, të cilët janë të plotësuar me rregulloret e shpallura nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ).

Korniza ligjore është reviduar në mënyrë substanciale në vitin 2015 si rezultat i marrëveshjes në Përzihino. Opinioni i Përbashkët i OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës për Kodin Zgjedhor solli konkluzione se shumë nga rekomandime e mëparshme ishin plotësuar, posaçërisht ato në lidhje me parimet e të drejtës së barabartë për votim jashtë vendit, përbërjen dhe kompetencat e KSHZ-së, nivelin e fushës për mbulim medial gjatë fushatës, përforcimet në raportimin dhe revizionin financiar partiak dhe të fushatës, dispozitat e përmirësuara për ndarje të partisë nga shteti dhe prezantimin e afateve për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore në gjykata.⁵ Megjithatë, Opinioni vëren se Kodi Zgjedhor do të përfitonte nga revidimi total me qëllim të harmonizimit të tij të brendshëm si dhe me ligjet tjera relevante, duke përfshirë edhe aspektin e regjistrimit të kandidatëve dhe të fushatave. Ndryshimet shtesë të bëra në Kodin Zgjedhor në korrik të vitit 2016 përmbajnë dispozita të zbatueshme vetëm për zgjedhjet e tashme. Këto përfshijnë formimin e Komisionit të Përkohshëm për mbikëqyrje të mediave dhe obligimin për qytetarët me të dhëna të “kontestueshme” për tu regjistruar në mënyrë aktive për këto zgjedhje.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet administrohen nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), 80 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe 3,480 Këshilla Zgjedhore (KZ). Janë formuar edhe 46 KZ në zyrat diplomatike-konsullore për votim jashtë vendit.

³ Shih Marrëveshjen e 20 korrikut.

⁴ Kandidati i parë zgjidhet nëse numri minimal i votave të fituara nga lista është i barabartë me numrin më të ulët të votave të fituara nga deputeti i zgjedhur në vend në zgjedhjet e fundit, e për zgjedhjet e ardhshme ky numër është 6,478 vota. Kandidati i dytë dhe i tretë zgjidhen nëse lista e tyre mbledh dyfishin, respektivisht trefishin e votave.

⁵ Shih [Opinionin](#) i përbashkët i OSBE/ODIHR dhe i Komisionit të Venecias për Kodin Zgjedhor të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Opinioni Nr. ELE-MKD/292/2016.

KSHZ përbëhet nga nëntë anëtarë: tre të emëruar nga partitë në qeveri, tre nga opozita, dhe tre ekspertë të pavarur të zgjedhur përmes rekrutimit të hapur. Kryetari dhe zëvendësi zgjidhen prej anëtarëve jo-partiak. KSHZ punësoi personel juridik dhe IT të emëruar nga katër partitë kryesore politike. KSHZ-ja është e mbështetur nga 34 zyra rajonale të përhershme.⁶

KKZ-të përbëhen nga pesë anëtarë që janë rastësisht të zgjedhur nga të punësuarit në administratën shtetërore dhe komunale. Përderisa shumica e KKZ-ve janë funksionale dhe përgatitjet për zgjedhjet janë në rrjedhë e sipër, disa prej tyre kanë mungesë të objekteve dhe pajisjeve adekuate.⁷ KZ-të përbëhen nga pesë anëtarë – tre punonjës nga administrata publike rastësisht të zgjedhur dhe dy të caktuar nga partitë kryesore në pushtet dhe opozitë.

Kodi Zgjedhor siguron përfaqësim të barabartë të grupeve etnike dhe gjinore në organet administrative zgjedhore. Duket se këto kërkesa janë të plotësuara në KKZ-të dhe KZ-të.⁸ Dy nga nëntë anëtarët e KSHZ-së janë gra dhe tre janë shqiptarë etnik.

Seancat zyrtare të KSHZ-së ishin të hapura për vëzhguesit dhe mediat. Megjithatë, KSHZ-ja po ashtu realizonte seanca të mbyllura në të cilat u mbajtën biseda substanciale për çështje për të cilat duhej të merreshin vendime në seanca publike. Vendimet e KSHZ-së zakonisht miratoheshin njëzëri, edhe pse anëtarët shpeshherë përfshiheshin në debate të gjata procedurale.⁹ Vendimet janë publikuar në kohë në faqen zyrtare të KSHZ-së në internet. Obligimi që proces verbal i nga seancat e KSHZ-së të publikohet brenda 48 orëve nuk është respektuar në mënyrë konsistente.¹⁰

KSHZ-ja përgatiti doracak për trajnim për KKZ-të dhe KZ-të. KKZ-të janë trajnuar në qershor dhe në korrik, kurse raundi i dytë i trajnimeve është në vijim. Trajnimi i vëzhguar nga MVZ i OSBE/ODIHR është vlerësuar pozitivisht nga pjesëmarrësit dhe nga shoqëria civile.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Qytetarët që mbushin moshën 18 vjeçe në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë vote përveç nëse me vendim gjyqësor janë të privuar nga cilësia e tyre ligjore. Regjistrimi i votuesve është pasiv, me përjashtim të votuesve që përkohësisht jetojnë jashtë vendit dhe të cilët duhet të regjistrohen në mënyrë aktive. E drejta e votimit iu jepet personave me adresë të regjistruar në shtet dhe që posedojnë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme. KSHZ-ja ka përgjegjësi për të mirëmbajtur Listën e votuesve në bazë të të dhënave nga ekstraktet civile dhe të popullsisë.¹¹ 1,784,524 votues janë të regjistruar për këto zgjedhje prej datës 18 nëntor 2016, duke përfshirë edhe 20,629 votues jashtë vendit.

Mosbesimi afatgjatë në saktësinë e Listës të votuesve vazhdoi nga zgjedhjet e më parme me akuza për regjistrim të dhënash të ndryshme joligjore. KSHZ-ja ishte e detyruar të bëjë revidimin e Listës së votuesve me anë të kontrollimit të kryqëzuar të bazave të të dhënave nga 11 institucione shtetërore, e përcjellë me kontrollime në terren të cilat ishin të vëzhguara nga katër partitë kryesore politike. Më 26 prill, KSHZ-ja raportoi 44,308 votues të identifikuar se jetonin në adresë me mbi 20 votues të

⁶ 17 zyra tjera shtesë kanë funksionuar deri më 11 nëntor, kryesisht për regjistrim të votuesve.

⁷ Siç u vëzhgua nga MVZ i OSBE/ODIHR në Novo Sellë, Orizarë, Kumanovë, Tetovë, Tearcë, Gostivar, Vrapçishtë, Mavrovë, Jegunoc, Zhelinë, Bërvenicë, Bogovinje dhe Kratovë.

⁸ Në komunat ku komunitetet etnike përbëjnë së paku 20 për qind të popullsisë, ato duhen të janë të përfaqësuar në KKZ-të dhe KZ-të.

⁹ Rregullat dhe Procedurat e KSHZ-së të vitit 2006 nuk rregullojnë organizimin e seancave dhe parashohin vetëm që kryetari i KSHZ-së të mund të ndërpresë bisedën kur ai/ajo vendos se çështja është shterur.

¹⁰ Proces verbalët e fundit të publikuara më 21 nëntor janë të datës 7 nëntor.

¹¹ Shumica e regjistrimeve të verifikuara me vendim të KSHZ-së faktikisht ishin bërë nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e cila mbikëqyrë Regjistrin Civil.

regjistruar ose me votues me më shumë se 6 mbiemra. Pas kontrollimeve të bëra në terren, 39,502 votuesve me “regjistrim të kontestueshëm” iu kërkua që të bëjnë reregjistrim në mënyrë aktive.¹² Më 13 nëntor, KSHZ-ja vendosi që të fshijë 28,341 votues nga Lista që nuk ishin reregjistruar. Edhe përskaaj kritikave për procedurat e kontrollimit në terren, një numër i bashkëbiseduesve të MVZ OSBE/ODIHR dhanë mendim se besimi në Listën e votuesve është ngritur pasi që procesi ka mundësuar një numër të kufizuar të korigjimeve.

Votuesit mund të kërkojnë regjistrim ose ndryshime në të dhënat në Listën e votuesve në zyrat rajonale të KSHZ-së gjatë tërë vitit. Në vitet kur mbahen zgjedhjet, votuesit po ashtu mund të kontrollojnë të dhënat e tyre por edhe gjatë periudhës së shqyrtimit (këtë vit kjo ishte prej 28 tetorit deri më 11 nëntor). Përkundër dispozitave ligjore, zyrat rajonale të KSHZ-së nuk publikuan Listë të printuar të votuesve dhe votuesit kishin mundësi të vetme të kontrollojnë të dhënat e tyre në kompjuterë në zyrat e KSHZ-se ose në internet. Gjithsej 10,274 votues vizituan zyrat e KSHZ-së, mirëpo numri i korigjimeve të kërkuara ishte i ulët.¹³ KSHZ-ja informoi votuesit për rezultatet e kërkesave të tyre vetëm përmes postës elektronike, siç është e paraparë me ligj. Ata pa adresë elektronike nuk u informuan.

Në fund të periudhës për shqyrtim, KSHZ-ja duhej tu siguronte kandidatëve zgjedhorë kopje preliminare të Listës së votuesve. Kjo u bë me vonesë dyditore si rezultat i mospajtimeve të brendshme në lidhje me formatin e të dhënave. Kandidatët zgjedhorë mund të kërkojnë korigjime deri më 23 nëntor.

KSHZ-ja aprovoi 20,629 nga 21,029 aplikime të dorëzuara për votim jashtë vendit.¹⁴ Shumë aplikime ishin bërë nga një adresë e njëjtë elektronike. Disa parti politike informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR se ato kanë asistuar votuesit gjatë aplikimit. Aplikimi përmes internetit kërkonte që votuesit të deklarojnë përkatësinë e tyre etnike, që sipas KSHZ-së, është e domosdoshme për printimin e materialeve zgjedhor në gjuhë të pakicave.¹⁵ Votuesit të cilët nuk u regjistruan do të mund të votojnë në shtet në vendvotimet sipas vendbanimit të tyre të fundit.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdonjëri me të drejtë vote mund të jetë kandidat për në parlament, përveç atyre të dënuar me aktvendim gjyqësor final me më shumë se gjashtë muaj dhe që nuk e kanë vuajtur dënimin e tyre. Ligji po ashtu identifikon se një sërë pozitash qeveritare ose të lidhura me qeverinë nuk janë në përputhje me kandidaturën.

Partitë politike të regjistruara, koalicionet e partive politike dhe grupet e votueseve mund të emërojnë kandidatë. Nga këto të fundit u kërkua që të sigurojnë 1,000 nënshkrime mbështetëse nga votuesit që jetojnë në njësinë përkatëse. Në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të OSBE/ODIHR, për herë të parë një votues mund të nënshkruajë mbështetje për më shumë se një listë të kandidatëve;

¹² Më 4 gusht, BESA ngriti ankesë në Gjykatën Kushtetuese për kushtetutshmërinë e nenit të ri 196.b të Kodit Zgjedhor i cili lejon KSHZ-në të fshijë votues të tillë nga Lista e votuesve. Gjykata refuzoi ankesën, mirëpo ngel që vendimi të shpallet në Gazetën Zyrtare.

¹³ 176 ishin për ndryshim të dhënave, 88 për shtesa në listë dhe 71 për fshirje për shkak të adresave të gabuara ose vdekjes.

¹⁴ Sipas KSHZ-së 76,721 qytetarë janë të regjistruar se jetojnë jashtë vendit në kohën e përpilimit të këtij raporti.

¹⁵ Materialet zgjedhore, përfshirë edhe fletëvotimet, duhet të jenë në gjashtë gjuhët e pakicave zyrtarisht të pranuar. Në njësitë ku së paku 20 për qind e popullsisë flet një prej këtyre gjuhëve listat e kandidatëve mund të dorëzohen në njërin prej atyre gjuhëve.

megjithatë nënshkrimet duhet të mblidhen në prezencën e të punësuarit të KSHZ-së në zyrën rajonale të KSHZ-së.

Regjistrimi i kandidatëve në përgjithësi ishte përfshirës. Deri në fund të afatit ligjor 11 nëntor, KSHZ-ja regjistroi 6 parti politike dhe 5 koalicione me gjithsej 1,092 kandidatë në 58 lista.¹⁶ Në pajtim me kuotën e rritur për zmadhimin e pjesëmarrjes së grave, 41 për qind e kandidatëve janë gra, mirëpo vetëm katër gra janë në krye të listave.¹⁷

VIII. FUSHATA DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Periudha zyrtare për fushatë filloi më 21 nëntor dhe do të përfundojë 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, shumica e partive politike filluan me mobilizimin e votuesve para kësaj kohe, duke organizuar evenimente dhe duke formuar shtabe zgjedhore. Partitë informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR se tubimet e përmasave të vogla dhe vizitat derë-më-derë do të jenë metodat kryesore për të arritur tek votuesit gjatë fushatës zgjedhore. Mesazhet kryesore të fushatës kanë të bëjnë me ekonominë, punësimet, gjyqësorin dhe migrimin e rinisë.

Atmosfera parazgjedhore ishte kryesisht e qetë edhe pse u regjistruan disa incidente të dhunshme.¹⁸ Në MVZ OSBE/ODIHR u raportua se kishte një numër akuzash të pambështetura për presion mbi të punësuarit në administratë për mbështetje të partive politike të caktuara, .¹⁹

Nga kandidatët kërkohet që të regjistrojnë numër unik tatimor dhe të hapin llogari bankare të dedikuara për qëllime të financimit të fushatës. Individë mund të bëjnë donacione deri më 3,000 euro kurse personat juridik deri më 30,000 euro. Donacionet nga jashtë vendit ose anonime dhe nga organizata në pronësi shtetërore, fetare dhe humanitare janë të ndaluara. Kandidatët mund të shpenzojnë maksimum 1.8 euro për votues të regjistruar në njësi. Çdo listë do të rimbursohet me 0,25 euro për çdo votë të fituar me kusht që të fitohen së paku 1.5 për qind e votave të hedhura në njësi.

Mbikëqyrja e financimit të fushatës kryesisht bëhet nga Enti Shtetëror i Auditimit. Kandidatët duhet të dorëzojnë dy raporte të përkohshme dhe një raport final në KSHZ, në Entin Shtetëror të Auditimit dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit. Të gjitha raportet do të publikohen në faqen e internetit të secilit institucion.

¹⁶ Koalicioni i VMRO-DPMNE-së 'Për Maqedoni më të mirë' përfshin 25 parti, kurse koalicioni i udhëhequr nga LSDM përfshinë 15 parti. Koalicionet tjera janë Aleanca për Shqiptarët (PDSH - Lëvizja për Reforma, *Uniteti* dhe RDK), Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi (Unioni Demokratik, FRODEM, MORO – Partia e Punëtorëve, dhe DEMOS) dhe VMRO-Koalicioni për Maqedoninë (VMRO-PP, Të Bashkuar për Maqedoninë dhe Krenaria). Gjashtë partitë e regjistruara janë BDI, PDSH, BESA, *Levica*, Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Partia Liberale (LP). Më shumë se gjysma e deputetëve të tanishëm nuk do të marrin pjesë në këto zgjedhje.

¹⁷ Kjo paraqet rritje të kuotës për 10 për qind krahasuar me zgjedhjet në vitin 2014. Çdo i treti dhe i dhjeti kandidat duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar.

¹⁸ Më 13 nëntor, vetura e liderit të BDI-së ishte gjuajtur me gurë nga një grup i banorëve lokal nga Kumanova; më 7 nëntor, dritaret e zyrës së re të shtabit zgjedhor të LSDM-së në Haraçinë ishin thyer, si edhe ato të VMRO-DPMNE-së në Kavadar më 18 nëntor; më 9 nëntor, vetura e kryetarit të degës të GROM-it në Strumicë ishte djegur.

¹⁹ Supozohet se punonjësit në administratë në Manastir kanë qenë të kërcënuar me humbje të vendit të punës nëse nuk do të votonin për BDI; në Ohër, vlerësimet e punës për punonjësit në administratë janë caktuar për një ditë pas zgjedhjeve – jashtë ciklit të rregullt, që nga punonjësit është konsideruar si presion nga ana VMRO-DPMNE; prej të punësuarve publik në Strumicë është kërkuar që të janë prezent gjatë inçizimit të videos për fushatë të LSDM-së.

IX. MEDIAT

Skena e mediave përfshin më se 130 radio dhe kanale televizive që operojnë në një treg relativisht të vogël me njësi mediale të ndara në vija politike dhe etnike. Televizioni është media më e rëndësishme dhe burim i informacioneve për rreth 75 për qind të popullatës.²⁰ Shumë nga bashkëbiseduesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR shprehën shqetësime lidhur me emetuesit dominues privat që mbështesin pikëpamjet e qeverisë, e që kanë prezencë të fuqishme në tregun e reklamimit. Vetë-censurimi shumë i pranishëm që është rezultat i presionit politik mbi mediat, së bashku me gjuhën nxitëse të disa gazetarëve dhe sulmet verbale mbi gazetarë (posaçërisht nga ana e zyrtarëve qeveritarë) ishin ca nga shqetësimet tjera që u vënë në pah para MVZ-së të OSBE/ODIHR.

Kodi Zgjedhor drejton mbulimin medial të zgjedhjeve. Amendamentet e konsiderueshme të bëra në vitin 2015 adresojnë reklamimin e financuar nga qeveria dhe mbulimin medial të zyrtarëve shtetëror duke favorizuar partitë politike gjatë zgjedhjeve. Ligji kërkon mbulim të balancuar dhe të barabartë gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore dhe i obligon mediat emetuese si dhe portalet në internet, që në rast se mbulojnë zgjedhjet, të veprojnë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme. Nga emetuesi publik, Radio-Televizioni i Maqedonisë (MRT), gjithashtu kërkohet të sigurojë qasje në emetim falas dhe të organizojë debate. Reklamimi politik është i lejuar vetëm në mediat private. Partive parlamentare u jepet e drejtë në përqindje më të madhe të mbulimit medial në lajme, emetim falas dhe reklamim të paguar në krahasim me garuesit tjerë.

Reforma të rëndësishme mediale të parapara me marrëveshjen e Përzhinos ende mbeten çështje për tu dakorduar. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nga viti 2016 lidhur me mediat janë të zbatueshme vetëm për këto zgjedhje. Kryeredaktori i MRT-së u emërua nga opozita 100 ditë para këtyre zgjedhjeve. Roli mbikëqyrës i Agjencisë për Media dhe Shërbime Audio dhe Audiovizuale (AMSHAV), që është organ rregullator për mediat emetuese dhe për mbulime mediale të zgjedhjeve, u zëvendësua me Komision të Përkohshëm. Organi pese anëtarësh, i cili përfshinë katër persona të emëruar nga katër partitë kryesore politike, kurse i pesti është i zgjedhur nga katër anëtarët, vlerëson mbulimin medial duke u bazuar në monitorimin e raporteve të rregullta për mediat të përgatitura nga AMSHAV. Prej 21 nëntorit, Komisioni solli vendime për një numër të rasteve të mbulimit të anshëm, marketing të fshehtë nga zyrtarët qeveritar dhe reklamim nga qeveria. Duke u bazuar në rekomandimet e saj, AMSHAV dorëzoi në gjykatën themelore 14 iniciativa për procedurë për kundërvajtje përfshirë gjashtë paralajmërime (MTV, *Nova*, *Alfa*, dhe *Sitel*) dhe tetë gjoba (*Alfa*, *Nova* dhe *Sitel*). Deri tani gjykata vendosi për njërin rast të *Nova*-s, të mos pranohet të merret në shqyrtim.

Më 7-të nëntor, MVZ e OSBE/ODIHR filloi vëzhgimin kualitativ dhe kuantitativ të mediave për tetë kanale televizive dhe pesë gazeta ditore.²¹

X. ANKESA DHE ANKIMIME

KSHZ-ja merret me shumicën e kontesteve civile dhe administrative që kanë të bëjnë me zgjedhjet, kurse Enti Shtetëror i Auditimit si dhe Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit merren me ankesat që kanë të bëjnë me financimin e fushatave dhe keqpërdorimin e burimeve administrative.

²⁰ Sipas [analizës](#) të bërë në vitin 2015 nga agjencia “Market Vision” në emër të Agjencisë për Media dhe Shërbime Audio dhe Audiovizuale (AMSHAV).

²¹ Programet kryesore të emetuara nga TV kanalet publike MRT-1 dhe MRT-2 dhe televizionet private *Sitel*, *Kanal5*, *Alfa*, *Telma* dhe *Alsat-M* (mes orës 18:00 dhe 24:00) si dhe programet e lajmeve kryesore të *Vesti 24* (emetim në ora 20:00) vëzhgohen çdo ditë së bashku me gazetatat ditore: *Dnevnik*, *Koha*, *Lajm*, *Sloboden Pecat* and *Vest*.

Vendimet e tyre mund të ankimohen në Gjykatën Administrative. Për shkak të natyrës së tyre penale, Gjykata Themelore merret me vepra të shkeljes zgjedhore.

Partia Social Demokratike e Maqedonisë dhe Lëvizja Qytetare për Maqedoninë ankimuan në Gjykatën Administrative vendimin e KSHZ-së për refuzimin e Listave të tyre të kandidatëve. Gjykata i shqyrtoi këto raste në një seancë të mbyllur dhe i refuzoi të gjitha ankimimet si të pabazë.²² Të gjitha vendimet ishin të publikuara në faqen e gjyqit në internet.

KSHZ-ja miratoi Rregulloren për procedura gjatë shqyrtimit të ankesave dhe ankimimeve. Në bazë të kushteve që dalin nga Kodi Zgjedhor u ndërtua një sistem elektronik për menaxhim të rasteve dhe ankesave, mirëpo ai ende duhet të testohet gjatë këtyre zgjedhjeve. Deri tani KSHZ-ja ka pranuar vetëm disa ankesa.

XI. PJESEMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Marrëdhëniet ndëretnike mbesin të jenë një faktor politik i rëndësishëm dhe partitë politike kanë tendencë që kryesisht ti afrohen komuniteteve të tyre. Partitë që përfaqësojnë pakicat, përveç shqiptarëve, shprehën pakënaqësitë e tyre tek MVZ e OSBE/ODIHR në lidhje me përjashtimin e tyre nga procesi politik i cili çoi në shpalljen e zgjedhjeve të 11 dhjetorit. Ata po ashtu shprehën qartë shqetësimin e tyre se sistemi zgjedhor nuk ofron mekanizma për promovimin e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare, siç janë vendet rezervuara apo të garantuara në parlament, që rrjedhimisht i detyron ato tu bashkëngjiten koalicioneve të udhëhequra nga partitë që përfaqësojnë komunitete më të mëdha. Disa prej shqetësimeve të shprehura para MVZ të OSBE/ODIHR kanë të bëjnë për shkallën jo të mjaftueshme dhe adekuate të publikimit të Listës së Votuesve “të kontestueshëm”, dhe nevoja që ata të reregjistrohen, për të mundësuar qasje tek të gjitha komunitetet.

Koalicionet e LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së kanë futur në listat e tyre përfaqësues nga pothuajse të gjitha komunitetet më të vogla, disa prej tyre në pozicione me mundësi për të fituar. LSDM-ja shprehu qëllimin e tyre për të kërkuar votat nga komuniteti etnik shqiptar. Gara zgjedhore është më kompetitive tek komuniteti etnik shqiptar, ku koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe BESA po sfidojnë pozitën dominuese të BDI-së. Përkundër mospajtimeve në fillim, shumica e liderëve të partive të ndryshme që përfaqësojnë komunitetin Rom vendosën që të garojnë në koalicionin e VMRO-DPMNE-së.

XII. QYTETARËT DHE VËZHguesIT NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor lejon vëzhgime të zgjedhjeve nga ana e qytetarëve, aktivistët partiak, dhe vëzhgues ndërkombëtarë. Dy organizata të mirënjohura qytetare do të vëzhgojnë këto zgjedhje: MOST ka 80 vëzhgues afatgjatë dhe synon të pozicionojë rreth 3,300 vëzhgues afatshkurtër, dhe gjithashtu planifikon të bëjë numërim tabelor paralel të votave; CIVIL ka 35 vëzhgues afatgjatë, 10 ekipe mobile dhe synon të shpërndajë rreth 300 vëzhgues afatshkurtër.

XIII. AKTIVITETET E MISIONIT

MVZ i OSBE/ODIHR filloi punën e saj në Shkup më 3 nëntor. Shefi i Misionit u takua me Ministrinë për Punë të Jashtme, KZSH-në, dhe përfaqësues të partive politike, mediat, organizata të shoqërisë

²² Sipas Kushtetutës, seancat gjyqësore dhe shpallja e aktvendimit janë publike. Publiku mundet të përjashtohet vetëm në rastet të përcaktuara me ligj. Kodi Zgjedhor parashih parimet e seancave publike ku trajtohen çështje zgjedhore nga ana KSHZ-së dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Po ashtu, Ligji për Gjykatat thotë se proceset në gjykatë duhet të bazohen mbi parimet e publicitetit dhe transparencës.

civile, Misionin e OSBE-së në Shkup dhe me komunitetin ndërkombëtar.²³ MVZ-ja vendosi kontakte me pjesëmarrësit në zgjedhjet në të gjitha nivelet. Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP OSBE), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) dhe Parlamenti Evropian (PE) kanë për qëllim të dërgojnë delegacione për vëzhgim në ditën e zgjedhjeve.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij Raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Në dispozicion janë edhe përkthimet jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe shqipe.*

²³ MVZ [OSBE/ODIHR](#) dhe [Misioni i OSBE-së](#) funksionojnë veçmas nën mandatet e tyre përkatëse.